



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.95/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje paraqitur kundër Muhamet Veseli kryesues i vendvotimit nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZONIT** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 23.01.2011, nga LVV-ja në të cilën theksohet se në Qendrën e votimit në 1129b/02 në shkollën Sylejman Vokshi, kryesuesi i vendvotimit Muhamet Veseli nga rradhët e PDK-së orienton votuesit me fjalët “voto ipko” që nënkupton numrin e PDK-së 49.

Sipas parashtresës të ankesës me këtë është bërë shkelja e nenit 6 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës zgjedhore 11/2009

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar. Vlen të theksohet fakti se parashtruesi i ankesës ka dështuar të identifikoj se cilët persona në rastin konkret janë orientuar që të votojnë për subjektin në fjalë dhe në çfarë mase ka qenë ndikimi i ushtruar ndaj tyre për të votuar subjektin e cekur në fjalë. PZAP vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës se ka orientuar votuesit vetëm me fjalët 'voto ipko' nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar se është shkelur Neni 6, paragrafi 1 pika b) e Rregullës Zgjedhore nr.11/2009. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A. nr. 95/2011 më datën 26.01.2011.

